



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVO

Br.

Data/Datum

468/20

21.08.20

PRISHTINE - PRIŠTINA



PSH .nr.468/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “ Ejona ” SH.P.K. Pejë , kundër njoftimit për kontratë dhe refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të Komunës ” , me nr. të prok: 616-20-2751-5-2-1, të iniciuar nga, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Kuvendi i Komunës së Prishtinës” , më datën: 20.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “ Ejona ” SH.P.K. Pejë, kundër njoftimit për kontratë dhe refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të Komunës ” , me nr. të prok: 616-20-2751-5-2-1, të iniciuar nga, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Kuvendi i Komunës së Prishtinës” .

II.OBLIGOHET autoriteti kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës që ti bëjë ndryshimet në dosje të tenderit, sipas konstatimeve të ekspertit shqyrtues dhe teknik dhe të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të Komunës ” , me nr. të prok: 616-20-2751-5-2-1, të iniciuar nga, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Kuvendi i Komunës së Prishtinës” .

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “ Ejona ” SH.P.K. Pejë , aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “ Ejona ” SH.P.K. Pejë , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.07.2020 me nr. 468/ 20, kundër njoftimit për kontratë dhe refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të Komunës ” , me nr. të prok: 616-20-2751-5-2-1, të iniciuar nga, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Kuvendi i Komunës së Prishtinës” ,

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 11.1 ,4.4 , 20.8 ,61.2 , si dhe 6.3 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 23.07.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “ Ejona ” SH.P.K. Pejë.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 të OE ankues... Pozicionet për PUNET E ASHENSORIT e keni kërkuar : ASHENSORI KP-OI: Q=630 kg; 8 PERSONA dhe kësaj ja keni bashkëngjitur në nr të pjesëve afër 30 komponentë?!!! Sipas pozicioneve nga nr 1.1 deri tek poz. 1.24 prandaj ju lutem na shkruani se këto pozicione janë vetëm furnizim me pjese rezerve për këtë ashensorë apo keni kërkuar qe ky ashensor ti këtë vetëm këto pjese te përmendura?

2. Vërejtja jonë në baze të përshkrimit Teknik konsiston se ju keni kërkuar në përshkrim Teknik Ashensor komplet por më pas edhe në përshkrim edhe në paramasë i keni cek pjesët me nr. rendor, nr. sasinë e pjesëve dhe çmimet veç e veç për pjesë, gjë që është e papranueshme. Sepse asnjëherë nuk ndodh as nga prodhues e

as nga kërkuesi qe dikush me bë kërkesë për pjesë të një ashensori dhe te na dërgojnë çmime veç e veç për secilën pjese.

3. Nëse ne bëjmë liferimin e pjesëve sipas kërkesës suaj aty nuk janë as 20% të pjesëve për një ashensor sepse sipas disa prodhuesve ka rreth 680 komponentë për me kompletu një ashensor dhe ju keni numru rreth 30 pjesë që janë të pa mjaftueshme për me kompletu një ashensor dhe neve prodhuesi - gjithsecili na jep ofertën për një ashensor të kompletuar sipas kërkesave teknike që parashtroni ju dhe jo çmime për pjesë veç e veç.

Andaj, sipas kërkesës suaj për Ashensor komplet, edhe paramasa duhet te jete Furnizimi dhe montimi i Ashensorit komplet me kapacitet dhe performanca te dëshiruara.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, dokumentit teknik **“Parathenja.pdf”** dhe paramases si dhe fakteve 1, 2, 3, 4 dhe 5 të kësaj ekspertize ku janë te paraqitura pjesë nga dokumenti i AK **“parashenja . pdf”**, mendoj që këto pozicione të cilat janë të paraqitura ne këtë dokument por edhe ne dokumentin ne formatin excel **“paramasa.xls”**, janë pjesë-module përbërëse te ashensorit të kërkuar dhe nuk janë menduar si pjesë rezervë ashtu siç keni pretenduar në ankesën tuaj, për mendimin tim, po ashtu nga përvoja dhe hulumtimi gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, mendoj qe AK ka kërkuar Ashensor komplet në bazë te specifikacionit të bashkangjitur DT, mirëpo çmimet më saktësisht ofertat nga ana e OE duhet të dorëzohen për module te veçanta ashtu siç janë te cekura në dokumentet e lartcekura.

Sa i përket Paramasës dhe Parallogaritë dokument ky i përgatitur nga AK-ja dhe i bashkangjitur si pjesë përbërëse e DT, është i ndarë në dy pjesë kryesore: Pjesa A janë te detajizuara 7 pozicione për punët ndërtimore dhe pjesën B – Punët e Ashensorit ne 25 pozicione. Në këto pozicione janë të precizuara saktë punët që duhen të kryhen deri në detaje deri tek lëshimi në punë i Ashensorit. Nuk e shoh si devijim në kërkesa nga ana e AK-së në saktësimi i punëve që duhet të kryhen është precizuar në mënyrë të detajuar sikurse që është paraqitur nga AK-ja në këtë dokument.


Andaj mendimi im është qe ky pretendim ankimor të refuzohet si i **pabazuar** nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2 ... Ju keni shkelur komplet rregullat e përmendura tek Pretendimi 1 për arsye se: Ju keni kërkuar në paramasen tuaj komponentët për ashensor me shifër dhe brend te caktuar, që vetëm një prodhues në botë i prodhon këto komponentë me këto shifra dhe i cili prodhues është një prej prodhuesve të kualitetit me të ulet në krahasim me shumë prodhues tjerë botëror?! Me këtë kërkesë ju na lini te kuptojmë se keni favorizua një OE te vetëm në kundërshtim me **A01_Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik** AK ka kërkuar specifikisht këtë ashensor, me kode dhe emra te prodhuesit, ndërsa ne përgjigjen e kërkesës për Rishqyrtim, na kane thënë se ky pretendim është i pabaze pasi qe nuk kemi prova?

E gjithë paramasa tek pozicionet e ashensorit, janë me kode dhe emra të këtij prodhuesi të ashensoreve. Andaj, ju lutem të mënjaroni kërkesat me brende dhe kode të veçanta të vetëm një prodhuesi.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT dhe NJK, si dhe fakteve të bashkangjitura në këtë ekspertizë, mendoj që AK ankues tek pozicioni B në paramasë, pra në pjesën ku edhe janë pretendimet ankimore, ka dhënë përshkrime shumë specifike ashtu që në të paktën dy pozicione të kësaj pjese të paramasës, **konkretisht pozitat 1.1 dhe 1.9 nga paramasa**, me kërkim të thjeshtë në internet me emërtim të produktit dërgojnë tek prodhuesi **“Kleemann”** konkretisht tek web faqja <https://kleemannlifts.com/products/>.

Për shembull me klikim në google për nën pjesën 1 të pjesës B të paramasës të paraqitur tek fakti 1, na shfaqet si në foton e mëposhtme:



Për këtë pretendim mendoj që AK në këtë rast ka dhënë detaje specifike që favorizojnë prodhues specifik, gjë e cila nuk është në përputhje me LPP dhe që bie ndesh me kërkesat dhe interpretimet tjera ligjore që e rregullojnë këtë fushë. Kurse disa nga pjesët-modulet tjera përbërëse të Pjesës B të Paramasës janë produkte të prodhuesve të ndryshëm të cilat inkorporohen brenda tërësisë (moduleve) përbërëse të Ashensorit dhe mendoj që ky pretendim ankimor të aprovohet si i bazuar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3 te OE ankues ... Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e këtij projekti (lamia e ashensoreve), ne e shohim te paarsyeshme se si AK nuk ka kërkuar staf te certifikuar dhe trajnuar për ashensore?

Andaj, ju lutem te plotësoni Kërkesat e Kapacitetit Teknik dhe Profesional, sepse ky projekt duhet te këtë se paku 1 inxhinier te Makinerisë, 1 inxhinier te Elektroteknikes dhe me se paku 10 punëtorë te trajnuar dhe certifikuar nga prodhues te Ashensorëve.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të pretendimeve te OE ankues, analizimit të DT, paramasës, NJK dhe faktit 6 të bashkangjitur në këtë ekspertizë si dhe bazuar edhe në përvojën e deritashme, mendoj që AK, me atë që kanë paraparë dhe që e kanë cekur tek pika 9.1 dhe 9.2 e DT, pra kapaciteti teknik dhe profesional ku është kërkuar qe OE të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit, me ç'rast si dëshmi të obliguar dokumentare kanë kërkuar listë te detajuar të kontratave te realizuara dhe të njëjtës ti bashkëngjesin referencat ose certifikatat për kryerje të punëve, për mendimin tim është kërkesë e mjaftueshme e cila në rast plotësimi do të ishte e mjaftueshme për plotësimin e këtij kushti, pa pasur nevojë të kërkohej detaje si në pretendimin e OE ankues dhe që nënkuptohet se një OE që i ofron të gjitha këto dëshmi, normalisht që në stafin e tij ka ekspertë dhe profesionistë të kësaj lëmije.

Andaj për mendimin tim ky pretendim ankimor është i **pabazuar** dhe i propozoj Panelit Shqyrtues që ta refuzojë këtë pretendim ankimor.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4 ... Tek kushtet e veçanta keni kërkuar: Shuma e parave të mbajtura është: 10% e vlerës se kontratës.

Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve (365 DITE). Kjo kërkesë për neve është e pakuptimte, pasi qe ne secilin aktivitet te prokurimit këtë kërkesë tuajën e zëvendëson SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TE KONTRATES ne afat garantues, si dhe Deklaratat e Garancionit te lëshuara nga OE konkurrues.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimor, DT dhe NJK, përgjigjes së AK në kërkesën për rishqyrtim si dhe faktit 7 te kësaj ekspertize pjesës tek specifikimi i sigurisë së tenderit dhe sigurisë se ekzekutimit, unë mendoj se ashtu siç e ka cekë edhe AK që pjesa e pretendimit në lidhje me mbajtjen e parasë zëvendësohet me sigurinë e ekzekutimit e cila është e caktuar në vlerë prej 10% të vlerës së kontratës, andaj mendoj që pretendimi 4 i OE ankues duhet të refuzohet si i **pabazuar** nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Përgjigje në pretendimin Ankimor 5 ... AK ka shkelur NENIN 6, duke mos i respektuar rregullat për kthim të përgjigjes brenda 3 ditëve të punës, ose paralajmërim me shkrim për vonesat e mundshme. AK nuk na ka kthyer përgjigjen për plote 7 dite pas pranimit të ankesës. AK as nuk na ka informuar për arsyet e vonesës në kthim të përgjigjes.

Pas pranimit të ankesës AK ka bërë shtyrjen e afatit për dorëzim të ofertave, mirëpo nuk ka kthyer përgjigje deri pas 1 jave.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimor, faktit 7 pika 6, si dhe me kontrollimin e detajuar të datës kur është bërë kërkesa për rishqyrtim, kur është pezulluar procedura nga ana e AK-së dhe kur është kthyer përgjigja nga ta, për më shumë shih tri fotot në vijim:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM	
Sipas Nenet 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092	
Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES	
Për Aktivitetin e Prokurimit:	
Nr i Prokurimit	616-20-2751-5-2-1
Nr i brendshëm	616 20 082 521
Sa i përket tenderit për	
Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të komunës	
1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK	
EJONA SH.P.K	
(Shëno emrin e plote të kompanisë suaj)	
ZAHAQ ZONA INDUSTRIALE	
(Adresa)	
PEJE	30000
(Vendi)	(Kodi postar)
049137987	
(Numri Telefonit)	(Numri i Faks-it)
HYSNI PRELVUKAJ	
(Emri i plote i përfaqësuesit të kompanisë suaj)	
INFO@EJONA.COM	
(Adresa elektronike)	
25.06.2020	
(Data e parashtrimit të kërkesës)	(Nënshkrimi dhe vula)

Dokumenti shtojca	
Versioni i tanishëm	01.07.2020 15:25
VENDIMI PER PEZULLIM TE AKTIVITETIT TE PROKURIMIT.pdf	
Hape:	Dokument PDF

Dokumenti shtojca	
Versioni i tanishëm	02.07.2020 13:16
Vendimi per rishqyrtim Ejona.PDF	
Hape:	Dokument PDF



Departamenti i Prokurimit

Prishtine : datë,02.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.07.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "EJONA", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të komunës", me Nr. të Prok: 616 20 082 521 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të "EJONA" të dt. 01.07.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të komunës", me 616 20 082 521 kundër Njoftimit për KONTRATE të AK-së, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "EJONA" me datë 01.07.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të komunës" me Nr. të Prok: Nr 616 20 082 521. Autoriteti Kontraktues, me datë 01.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Lidhur me pretendimin tuaj për pershkrimet jo të duhura për ashensorin dhe pjesët ju sqarojme se kjo ka të bëjë me Njesinë e Kërkesës dhe jo si që pretendoni ju me Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit. Poashtu paraqitja e cmimeve për pjesë apo në total për ashensorin nuk paraqet asnjë shkelje pasi që Autoriteti Kontraktues kjo i jep oferte të detajuara, ndërsa besoj se as për tenderuesit nuk paraqet problem, pasi që në vlerësim llogaritet cmimi total;

Nga ku shihet se OE ka bërë kërkesën për rishqyrtim me datë 25.06.2020, si në foton 1, por në foton 2 shihet se vendimi për pezullim të aktivitetit dhe përgjigja në kërkesën për rishqyrtim nga ana e AK-së është ngarkuar në e-prokurim me datë 01 respektivisht 02.07.2020, e gjithashtu në foton 3 më lartë shihet tek përgjigja e AK-së "e kam hijezuar" ku e ka çekur që kërkesa për rishqyrtim është bërë me 01.07 kurse përgjigja me 02.07.2020, gjë e cila për mendimin tim është konstatim i gabuar nga ana e AK-së dhe në këtë rast nuk kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore, konkretisht nuk i janë përmbajtur afatit ligjor për kthim të përgjigjes në përputhje me faktin 6 dhe nuk e kanë pezulluar procedurën e prokurimit, andaj mendoj që ky pretendim ankimor është i bazuar dhe propozoj që si i tillë të aprovohet nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Eksperti teknik mendon së AK gjatë udhëheqjes së procedurës së prokurimit në fjalë, nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë nenet dhe dispozitat ligjore.

Andaj ne mendojmë që ankesa e OE të aprovohet si **pjesërisht e bazuar** nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, ndërsa me vendim të obligohet AK që ti heq nga pjesa B e paramasës pjesët konkretisht emërtimet e moduleve të cilat favorizojnë një prodhues të caktuar dhe ti lejnë ato si kuptime gjenerike në mënyrë që për këtë procedurë të prokurimit të mos favorizohet ndonjë prodhues-operator specifik.

Mendimi i ekspertëve shqyrtues-teknik : Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues dhe ai teknik i propozojnë Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si **pjesërisht e bazuar** dhe të obligohet AK që ti bëjë ndryshimet në pjesën e paramasës sipas mendimeve-rekomandimeve të cekura në këtë ekspertizë.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 23.07.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 27.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet vetëm me pretendimin nr.2 të ekspertëve shqyrtues-teknik.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 20.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për kontratë.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Pozicionet për PUNET E ASHENSORIT e keni kërkuar : ASHENSORI KP-OI: Q=630 kg; 8 PERSONA dhe kësaj ja keni bashkëngjitur në nr të pjesëve afër 30 komponentë?!!! Sipas pozicioneve nga nr 1.1 deri tek poz. 1.24 prandaj ju lutem na shkruani se këto pozicione janë vetëm furnizim me pjese rezerve për këtë ashensorë apo keni kërkuar qe ky ashensor ti ketë vetëm këto pjese te përmendura?

2. Vërejtja jonë në bazë të përshkrimit Teknik konsiston se ju keni kërkuar në përshkrim Teknik Ashensor komplet por më pas edhe në përshkrim edhe në paramasë i keni çek pjesët me nr. rendor, nr. sasinë e pjesëve dhe çmimet veç e veç për pjesë, gjë që është e papranueshme. Sepse asnjëherë nuk ndodh as nga prodhues e as nga kërkuesi që dikush me bë kërkesë për pjesë të një ashensori dhe te na dërgojnë çmime veç e veç për secilën pjesë.

3. Nëse ne bëjmë liferimin e pjesëve sipas kërkesës suaj aty nuk janë as 20% të pjesëve për një ashensor sepse sipas disa prodhuesve ka rreth 680 komponentë për me kompletu një ashensor dhe ju keni numru rreth 30 pjesë që janë të pa mjaftueshme për me kompletu një ashensor dhe neve prodhuesi - gjithsecili na jep ofertën për një ashensor të kompletuar sipas kërkesave teknike që parashtroni ju dhe jo çmime për pjesë veç e veç.

Andaj, sipas kërkesës suaj për Ashensor komplet, edhe paramasa duhet te jete Furnizimi dhe montimi i Ashensorit komplet me kapacitet dhe performanca te dëshiruara.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues teknik pas shqyrtimit të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, dokumentit teknik **“Parathenja.pdf”** dhe paramases si dhe fakteve 1, 2, 3, 4 dhe 5 të raportit te ekspertizës ku janë te paraqitura pjesë nga dokumenti i AK **“parashenja . pdf”**, konstaton që këto pozicione të cilat janë të paraqitura në këtë dokument por edhe ne dokumentin ne formatin excel **“paramasa.xls”**, janë pjesë-module përbërëse te ashensorit të kërkuar dhe nuk janë menduar si pjesë rezervë ashtu siç keni pretenduar në ankesën tuaj, për mendimin e ekspertit teknik konstatojmë se AK ka kërkuar Ashensor komplet në bazë te specifikacionit të bashkangjitur DT, mirëpo çmimet më saktësisht ofertat nga ana e OE duhet të dorëzohen për module te veçanta ashtu siç janë te cekura në dokumentet e lartcekura.

Sa i përket Paramasës dhe Paralogaritë dokument ky i përgatitur nga AK-ja, dhe i bashkangjitur si pjesë përbërëse e DT, është i ndarë në dy pjesë kryesore: Pjesa A janë te detajizuara 7 pozicione për punët ndërtimore dhe pjesën B – Punët e Ashensorit ne 25 pozicione. Në këto pozicione janë të precizuara saktë punët që duhen të kryhen deri në detaje deri tek lëshimi në punë i Ashensorit. Nuk e shoh si devijim në kërkesa nga ana e AK-së në saktësimi i punëve që duhet të kryhen është precizuar në mënyrë të detajuar sikurse që është paraqitur nga AK-ja në këtë dokument, andaj pretendimi ankimor është i **pabazuar**.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Ju keni shkelur komplet rregullat e përmendura tek Pretendimi 1 për arsye se: Ju keni kërkuar në paramasen tuaj komponentët për ashensor me shifër dhe brend te caktuar, që vetëm një prodhues në botë i prodhon këto komponentë me këto shifra dhe i cili prodhues është një prej prodhuesve të kualitetit me të ulët në krahasim me shumë prodhues tjerë botëror?!!! Me këtë kërkesë ju na lini te kuptojmë se keni favorizua një OE te vetëm në kundërshtim me A01_Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik AK ka kërkuar specifikisht këtë ashensor, me kode dhe emra te prodhuesit,

ndërsa ne përgjigjen e kërkesës për Rishqyrtim, na kane thënë se ky pretendim është i pabaze pasi qe nuk kemi prova?

E gjithë paramasa tek pozicionet e ashensorit, janë me kode dhe emra te këtij prodhuesi te ashensoreve. Andaj, ju lutem te mënjanoni kërkesat me brende dhe kode te veçanta te vetëm një prodhuesi.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues teknik pas shqyrtimit të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT dhe NJK, si dhe fakteve të bashkangjitura ne këtë ekspertizë, konstaton se AK tek pozicioni B në paramasë, pra në pjesën ku edhe janë pretendimet ankimore, ka dhënë përshkrime shumë specifike ashtu qe në te paktën dy pozicione të kësaj pjese të paramasës, **konkretisht pozitat 1.1 dhe 1.9 nga paramasa**, me kërkim të thjeshtë në internet me emertim të produktit dërgojnë tek prodhuesi **“Kleemann”** konkretisht tek web faqja <https://kleemannlifts.com/products/>.

Për shembull me klikim në google për nën pjesën 1 të pjesës B te paramasës të paraqitur tek fakti 1, na shfaqet si në foton e mësipërme.

Andaj nga te cekurat si më lart konstatojmë se AK në këtë rast ka dhënë detaje specifike që favorizojnë prodhues specifik, gjë e cila nuk është në përputhje me LPP dhe që bie ndesh me kërkesat dhe interpretimet tjera ligjore që e rregullojnë këtë fushë. Kurse disa nga pjesët-modulet tjera përbërëse të Pjesës B të Paramasës janë produkte të prodhuesve të ndryshëm të cilat inkorporohen brenda tërësisë (moduleve) përbërëse te Ashensorit, andaj ky peretendim eshte i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e këtij projekti (lamia e ashensoreve), ne e shohim te paarsyeshme se si AK nuk ka kërkuar staf te certifikuar dhe trajnuar për ashensore? Andaj, ju lutem te plotësoni Kërkesat e Kapacitetit Teknik dhe Profesional, sepse ky projekt duhet te këtë se paku 1 inxhinier te Makinerisë, 1 inxhinier te Elektroteknikes dhe me se paku 10 punëtorë te trajnuar dhe certifikuar nga prodhues te Ashensorëve.

Paneli shqyrtues konform Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të pretendimeve te OE ankues, analizimit të DT, paramasës, NJK dhe faktit 6 të bashkangjitur në ekspertizë konstaton se AK, me atë që kanë paraparë dhe që e kanë cekur tek pika 9.1 dhe 9.2 e DT, pra kapaciteti teknik dhe profesional ku është kërkuar qe OE të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit, me ç’rast si dëshmi të obliguar dokumentare kanë kërkuar listë te detajuar të kontratave te realizuara dhe të njëjtës ti bashkëngjesin referencat ose certifikatat për kryerje të punëve, është kërkesë e mjaftueshme e cila në rast plotësimi do të ishte e mjaftueshme për plotësimin e këtij kushti, pa pasur nevojë të kërkohen detaje si në pretendimin e OE ankues dhe që nënkuptohet se një OE që i ofron të gjitha këto dëshmi, normalisht që në

stafin e tij ka ekspertë dhe profesionistë të kësaj lëmi, andaj pretendimi i ankuesit për këtë pike është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se tek kushtet e veçanta keni kërkuar: Shuma e parave të mbajtura është: 10% e vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë të mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve (365 DITE). Kjo kërkesë për neve është e pakuptimte, pasi që ne secilin aktivitet të prokurimit këtë kërkesë tuajën e zëvendëson SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS në afat garantuës, si dhe Deklaratat e Garancionit të lëshuara nga OE konkurrues.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues teknik pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimor, DT dhe NJK, përgjigjes së AK në kërkesën për rishqyrtim si dhe faktit 7 të ekspertizës pjesës së specifikimit të sigurisë së tenderit dhe sigurisë së ekzekutimit, konstaton se ashtu siç e ka cekë edhe AK që pjesa e pretendimit në lidhje me mbajtjen e parasë zëvendësohet me sigurinë e ekzekutimit e cila është e caktuar në vlerë prej 10% të vlerës së kontratës, andaj pretendimi i ankuesit në këtë pike është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK ka shkelur NENIN 6, duke mos i respektuar rregullat për kthim të përgjigjes brenda 3 ditëve të punës, ose paralajmërim me shkrim për vonesat e mundshme. AK nuk na ka kthyer përgjigjen për plotë 7 ditë pas pranimit të ankesës. AK as nuk na ka informuar për arsyet e vonesës në kthim të përgjigjes. Pas pranimit të ankesës AK ka bërë shtyrjen e afatit për dorëzim të ofertave, mirëpo nuk ka kthyer përgjigje deri pas 1 jave.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues teknik pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimor konstaton se OE ka bërë kërkesën për rishqyrtim me datë 25.06.2020, vendimi për pezullim të aktivitetit dhe përgjigja në kërkesën për rishqyrtim nga ana e AK-së është ngarkuar në e-prokurim me datë 01 respektivisht 02.07.2020, përgjigja e AK-së "e është hijezuar" ku është cekur që kërkesa për rishqyrtim është bërë me 01.07 kurse përgjigja me 02.07.2020, gjë e cila është konstatim i gabuar nga ana e AK-së dhe në këtë rast nuk kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore, konkretisht nuk i janë përmbajtur afatit ligjor për kthim të përgjigjes në përputhje me faktin 6 dhe nuk e kanë pezulluar procedurën e prokurimit, andaj ky pretendim ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit teknik konstaton se AK gjatë udhëheqjes së procedurës së prokurimit në fjalë, nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë nenet dhe dispozitat ligjore. Andaj ankesa e OE aprovohet si

pjesërisht e bazuar , ndërsa obligohet AK që ti heq nga pjesa B e paramasës pjesët konkretisht emërtimet e moduleve të cilat favorizojnë një prodhues të caktuar dhe ti lejnë ato si kuptime gjenerike në mënyrë që për këtë procedurë të prokurimit të mos favorizohet ndonjë prodhues-operator specifik.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se AK ka hartuar specifikacione teknike në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që ti bëjë ndryshimet në pjesën e paramasës sipas mendimeve-rekomandimeve të cekura në raportin e ekspertizë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pa kënaqur me kërkesë padë mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 /AK/ /- “ Kuvendi i Komunës së Prishtinës” ,

1x1 / OE/ “ Ejona ” SH.P.K. Pejë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.